



TURIZMI NË SHIFRA

SHQIPËRI
2019

Udhëtimi është pasioni i cili të mban gjallë



Parathënie dhe Mirënjohe

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, hartoi një publikim të veçantë për treguesit kryesorë mbi turizmin në Shqipëri. Duke iu referuar periudhës 2014-2018, statistikat në lidhje me turistët e huaj dhe vendas në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e turizmit në vendin tonë.

Në strategjinë e re të komunikimit, INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve, duke targetuar grupe të ndryshme përdoruesish, duke bërë një publikim më të kuptueshëm nga përdoruesit. Materiali pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi turistët të huaj dhe vendas dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare. Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të grupeve të interesit në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është kontribut, jo vetëm i INSTAT, por dhe i furnizuesëve të të dhënave, duke veçuar ministritë e linjës dhe Bankën Qendrore.

INSTAT për hartimin e publikimeve të dedikuara po bën përpjekje të vazhdueshme dhe do të bashkëpunojë me çdo institucion për të sjellë tek përdoruesit informacion të vlefshëm, që do të ndihmojnë në vendimmarrje më të mirë. Ky botim është dëshmi e kësaj pune.

Delina IBRAHIMAJ, PHD
Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT

PËRMBAJTJA

	Hyrje	7
1	KARAKTERISTIKAT E TURISTËVE TË HUAJ NË SHQIPËRI	8
2	KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË UDHËTIMEVE TË SHTETASVE SHQIPTARË REZIDENTË JASHTË VENDIT	13
3	KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË UDHËTIMEVE TË SHTETASVE SHQIPTARË REZIDENTË BRENDË VENDIT	16
4	SA I RËNDËSISHËM ËSHTË TURIZMI NË EKONOMI?	18
5	KAPACITETET AKOMODUESE NË SHQIPËRI	20
6	AKTIVITETE TË TJERA TURISTIKE	21



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SHQIPËRISË

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



SIPËRFAQJA TOTALE	28,748 km ²
POPULLSIA	2,9 milionë banorë
KRYEQYTETI	Tirana (0,86 milionë banorë)
GJATËSIA KUFITARE	1094 km
- GJATËSIA TOKËSORE	657 km
- GJATËSIA BREGDETARE	316 km
- GJATËSIA LUMORE	48 km
- GJATËSIA LIQENORE	73 km




Kush?

Shqipëria është e parapëlqyer më shumë nga turistët kosovarë...

Kur?

Rreth 25 % e shtetasve të huaj vijnë në muajin gusht...



Pse?

4 nga 10 shtetas të huaj që kanë hyrë në vendin tonë gjatë periudhës 2014-2018, kanë ardhur për pushime...

Sa?

Mesatarisht dy shtetas të huaj për çdo shqiptar gjatë 2018...



Si?

Rreth 8 nga 10 shtetas të huaj hyjnë në Shqipëri me rrugë tokësore...

Vetëm gjatë vitit 2018 janë dhënë 75 leje për ndërtimin e "Hotele dhe struktura të ngjashme", tre leje më shumë sesa janë dhënë gjatë gjithë periudhës 2014-2017 (72)



Në Shqipëri ka mesatarisht 5 Hotele për 100 Km²...

Më shumë se 17.000 dhoma dhe 38.000 shtretër ishin në dispozicion të turistëve në 2018...



HYRJE

Industria e turizmit zë një vend të rëndësishëm në ekonomi dhe është një burim i madh dhe i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Turizmi mund të japë një kontribut të rëndësishëm në tre dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm: të krijojë vende pune, të gjenerojë mundësi tregtare për të njohur nevojat dhe mbështetur aktivitetet e turizmit, të krijojë kapacitetet e rëndësishme që promovojnë përparësitë për ruajtjen mjedisore dhe larminë kulturore.

Prodhimi i statistikave të harmonizuara me ofertën dhe kërkesën e turizmit, sot konsiderohet si vendimtar për t'u mundësuar vendimmarrësve të vlerësojnë dhe përmirësojnë këtë sektor të rëndësishëm ekonomik.

Ky material i përgatitur nga INSTAT, përfshin të dhënat për vitet referencë 2014-2018.

Materiali përbëhet nga gjashtë kapituj. Kapitulli i parë paraqet karakteristikat e hyrjeve të shtetasve të huaj sipas rajoneve, mënyrës së udhëtimit, kohëzgjatjes së qëndrimit, si edhe shpenzimet e shtetasve të huaj në Shqipëri.

Kapitulli i dytë flet për daljet e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, shpenzimet sipas qëllimit të vizitës, destinacionet kryesore etj.

Kapitulli i tretë flet për udhëtimet e shtetasve shqiptarë rezidentë brenda vendit, shpenzimet sipas qëllimit të vizitës, destinacionet kryesore etj.

Kapitulli i katërt paraqet disa tregues makroekonomikë si, shpenzimet e shtetasve të huaj në raport me PBB, shpenzimet e shtetasve shqiptarë rezident jashtë vendit ndaj totalit të importeve të mallrave dhe shërbimeve, vlerën e shtuar dhe numrin e punonjësve të aktiviteteve që lidhen direkt me turizmin.

Kapitulli i pestë fokusohet në kapacitetet akomoduese në Shqipëri, duke dhënë informacion mbi numrin e njësive akomoduse, numrin e dhomave gjithsej, numrin e shtretërve dhe shfrytëzimin e tyre.

Kapitulli i gjashtë fokusohet në aktivitetet e tjera turistike, duke dhënë informacion mbi numrin e vizitorëve në parqe arkeologjike, në muze, në kala dhe monumente. Duke iu referuar periudhës 2014-2018, statistikën në lidhje me turistët e huaj dhe vendas në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e turizmit në vendin tonë.


Gjetjet kryesore të shkruara në material tregojnë se hyrjet e shtetasve të huaj në vitin 2018 janë rritur 15,8 % më shumë se viti 2017, ndërsa shpenzimet e turistëve të huaj (jo-rezidentë) në vendin tonë janë rritur 12,5 %.

Në vitin 2018 daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur 4,4 % më shumë se viti 2017, ndërsa shpenzimet e shtetasve shqiptarë rezidentë jashtë vendit janë rritur me 17,3 %, krahasuar me një vit më parë.

1. KARAKTERISTIKAT E VIZITORËVE TË HUAJ NË SHQIPËRI

Të huaj që kanë hyrë në vend...


Në periudhën 2014-2018, hyrjet e shtetasve të huaj që vijnë në Shqipëri kanë qenë afërsisht 23.6 milionë persona. Vetëm gjatë vitit 2018, hyrjet e shtetasve të huaj janë 15,8 % më shumë se viti 2017.



Gjatë vitit 2018, hyrjet e shtetasve nga rajoni i Evropës zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj me 89,5 %, duke u rritur me 13,2 %.



Shtetasit e huaj që hyjnë në Shqipëri vijnë kryesisht nga këto shtete: Kosova (35 %), Maqedonia e veriut (11 %), Greqia (9 %), Mali i Zi (6 %) dhe Italia (7 %).



Rrugët hyrëse



Në periudhën 2014-2018, me rrugë ajrore kanë mbërritur afërsisht 2,5 milionë shtetas të huaj, duke u rritur me 19,7 % gjatë 2018. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet linjave ajrore zënë mesatarisht 10,5 % të hyrjeve gjithsej.

Në periudhën 2014-2018, numri i shtetasve të huaj që mbërrijnë në Shqipëri me linjat detare ka qënë afërsisht 1,5 milionë duke u rritur me 11,8 % gjatë 2018. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet linjave detare zënë mesatarisht 6,4 % të hyrjeve gjithsej.

Në periudhën 2014-2018, numri i shtetasve të huaj që mbërrijnë në vendin tonë nëpërmjet tokës ka qënë afërsisht 19,6 milionë, duke u rritur me 15,6 % gjatë 2018. Shtetasit e huaj që hyjnë në vendin tonë nëpërmjet tokës zënë pjesën më të madhe me 83,1 % të hyrjeve gjithsej për periudhën 2014-2018.



Tab 1. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas mënyrës së mbërritjes, në mijë

Nr,	Përshkrimi	2014	2015	2016	2017	2018
	Hyrjet e shtetasve të huaj gjithsej I+II+III	3.673	4.131	4.736	5.118	5.927
I	ME AJËR	337	401	457	578	692
II	ME DET	202	215	279	396	439
III	ME TOKË	3.134	3.515	3.999	4.144	4.796

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme

Cilat pika kufitare presin fluksin më të madh të vizitorëve të huaj?



Pikat kufitare që presin fluksin më të madh të shtetasve të huaj që vizitojnë Shqipërinë janë: Morina (35 %), Muriqani (12 %) dhe Rinasi (12 %)

Tab 2. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas pikave kufitare

Hyrjet e Shtetasve të huaj			
Pika kufitare		2018	
		Nr.	%
Blladë		86.628	1
Kakavijë		280.999	5
Qafë Botë		182.252	3
Kapshticë		188.263	3
Qafë Thanë		513.987	9
Morinë		2.081.209	35
Hani i Hotit		398.828	7
Muriqan		724.142	12
Durrës		177.994	3
Sarandë		236.313	4
Rinas		691.550	12
Të tjera		364.638	6
Totali		5.926.803	100

Në periudhën 2014-2018, numri i vizitorëve të huaj me netë qëndrimi (ku përfshihen vizitorët që qëndrojnë të paktën një natë në hotel apo në struktura akomoduese të tjera, tek të afërmit, shtëpitë e tyre, etj) është rreth 21 milionë duke u rritur me 10,7 % gjatë 2018. Ndërsa numri i vizitorëve ditorë, për harkun kohor 2014-2018, është rreth 1,7 milionë, duke u dyfishuar gjatë vitit 2018, krahasuar me vitin 2017.

Vizitorë me netë qëndrimi?

Tab 3. Numri i vizitorëve të huaj me netë qëndrimi dhe ditorë, në mijë

Përshkrimi	2014	2015	2016	2017	2018
Hyrje gjithsej	3.673	4.131	4.736	5.118	5.927
Vizitorë me netë qëndrimi	3.341	3.784	4.070	4.643	5.142
Vizitorë ditorë	127	162	507	293	587

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme dhe INSTAT



Në periudhën 2014-2018, hyrjet e shtetasve të huaj për qëllime personale: (pushime, vizitë në të afërm, trajtim shëndetësor, qëllime fetare etj) zënë pjesën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj, mesatarisht 98,7 %. Numri i hyrjeve të shtetasve të huaj për qëllime personale është rritur me 15,7 % në 2018, krahasuar me një vit më parë. Ndërsa hyrjet për qëllime biznesi zënë 1,5 % të hyrjeve gjithsej, duke u rritur 27,2 % në 2018, krahasuar me një vit më parë.

Tab 4. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit kryesor të vizitës, në mijë

Perishkrimi	2014	2015	2016	2017	2018
1+2 Hyrjet e shtetasve të huaj (gjithsej)	3.673	4.131	4.737	5.118	5.927
1 Personale	3.624	4.089	4.678	5.049	5.840
1.1 -Pushime	1.315	1.579	1.920	2.371	2.784
1.2 -Të tjera qëllime personale	2.309	2.510	2.758	2.678	3.056
2 Biznesi dhe profesionale	48	42	59	69	87

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme dhe INSTAT

Shtetasit e huaj, referuar të dhënave të vitit 2018, kanë kaluar mesatarisht 4,3 netë qëndrimi në Shqipëri, duke shpenzuar mesatarisht 52 euro në ditë. Shtetasit e huaj jo rezidentë për vitin 2018, kanë qëndruar kryesisht në hotel (76 %) dhe kanë ardhur me makina private (81 %).

Shtetasit e huaj që preferojnë të vizitojnë Shqipërinë, për vitin 2018, janë shtetasit nga Kosova.

Shqipëria destinacion i preferuar (2018)



- shteti që na preferon:
Kosova



- netë qëndrimi mesatar:
4,3 ditë



- shpenzimet mesatare
ditore për person:
52 Euro



- vendqëndrimi:
Hotel (76%)



- mjeti transportit:
Makinë private (81%)

Burimi: Banka e Shqipërisë



Kosovarët

	netë qëndrimi mesatar: 3,8 ditë
	92 % për pushime
	74 % qëndrojnë në hotel
	shpenzimet mesatare ditore për person: 43 Euro

81 % 19 %



Maqedonasit

	netë qëndrimi mesatar: 3,9 ditë
	91 % për pushime
	77 % qëndrojnë në hotel
	shpenzimet mesatare ditore për person: 46 Euro

85 % 15 %



Malazezët

	netë qëndrimi mesatar: 3,7 ditë
	72 % për pushime
	93 % qëndrojnë në hotel
	shpenzimet mesatare ditore për person: 60 Euro

95 % 5 %



Grekët

	netë qëndrimi mesatar: 3,6 ditë
	62 % për pushime
	79 % qëndrojnë në hotel
	shpenzimet mesatare ditore për person: 59 Euro

71 % 26 % 3 %



Italianët

	netë qëndrimi mesatar: 6,8 ditë
	64 % për pushime
	59 % qëndrojnë në hotel
	shpenzimet mesatare ditore për person: 81 Euro


46 % 9 % 16 % 29 %

Burimi: Banka e Shqipërisë


2. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË UDHËTIMEVE TË SHTETASVE SHQIPTARË REZIDENTË JASHTË VENDIT

Shqiptarët duken më shumë të dhënë pas pushimeve verore. Daljet e shtetasve shqiptarë jashtë vendit kulmojnë në muajin gusht, referuar të dhënave të vitit 2018.

Fig 1. Shpërndarja mujore e daljeve të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, 2018



Në periudhën 2014-2018, daljet e shtetasve shqiptarë jashtë vendit kanë qenë 24,1 milionë persona. Në vitin 2018 daljet e shtetasve shqiptar kanë pasur rritje prej 4,4 %. Shpenzimet e shtetsave shqiptarë rezidentë jashtë vendit për vitin 2018 kanë qenë 181.396 milionë lekë, duke u rritur me 17,3 % krahasuar me një vit më parë. Shpenzimet e shtetsave shqiptarë rezidentë për udhëtime personale zënë pjesën më të madhe, mesatarisht 77 % dhe shpenzimet për udhëtime biznesi profesionale 23 % të shpenzimeve gjithsej.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Shtetasit shqiptarë rezidentë, referuar të dhënave të vitit 2018, kanë kaluar mesatarisht 7,5 netë qëndrimi jashtë vendit, duke shpenzuar mesatarisht 47 Euro në ditë. Daljet e shtetasve shqiptarë rezidentë jashtë vendit për 2018 kanë qenë kryesisht për qëllim pushimesh (rreth 59 % të daljeve) dhe vizita te miqtë e të afërmit (rreth 30 % të daljeve).

TË DASHURUAR PAS PUSHIMEVE...

TË PREFERUARAT E REZIDENTËVE SHQIPTARË PËR PUSHIME JASHTË VENDIT (2018)

- DESTINACIONI I PREFERUAR: GREQIA
- NETË QËNDRIMI MESATARE: 5,9 NETË
- SHPENZIMET MESATARE DITORE PËR PERSON: 46 EURO
- VENDQËNDRIMI: HOTEL (59 %)
- MJETE TRANSPORTI: MAKINË PRIVATE (59 %)






Të preferuarat e shtetasve shqiptarë rezidentë për pushime jashtë vendit (2018)



Burimi: Banka e Shqipërisë




Burimi: Banka e Shqipërisë

3. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË UDHËTIMEVE TË SHTETASVE SHQIPTARË REZIDENTË BRENDIA VENDIT

Përqëndrimi më i lartë i udhëtimeve (personale dhe biznes), për vitin 2017, në Shqipëri sipas muajit të nisjes janë regjistruar në muajt: Gusht (rreth 14 %), Korrik (rreth 9 %), Qershor (rreth 10 %) dhe Mars (rreth 13 %).

Fig 2. Përqindja e udhëtimeve (personale dhe biznes) në Shqipëri sipas muajit të nisjes




Pse udhëtojnë shqiptarët rezidente brenda vendit 2017

Destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri, për vitin 2017, janë qarqet: Tiranë (rreth 28 %), Vlorë (rreth 13 %), Durrës (rreth 11 %) dhe Korçë (rreth 11 %).



Për vitin 2017, përqindjet më të larta të udhëtimeve të kryera për qëllimin “Pushime dhe kohë e lirë” janë regjistruar në Vlorë (35 %), ndërsa për kategorinë “Vizita te të afërm dhe miq” dhe udhëtimeve për qëllime “Biznesi” destinacionin e preferuar e kanë pasur drejt qarkut të Tiranës, respektivisht me 29 % dhe 32 % të udhëtimeve.



Udhëtimet e shqiptarëve rezidentë brenda vendit (2017):

**Sa zgjat?
Sa kushton?**



mesatarisht 3,6 netë qëndrimi;



një udhëtim për qëllime biznesi kushton rreth 2,5 herë më shumë se për qëllime personale;




Rreth 59 % e shpenzimeve për një udhëtim shkon për Akomodim dhe Ushqim;


4. SA I RËNDËSISHËM ËSHTË TURIZMI NË EKONOMI?

Në periudhën 2014-2018, pesha specifike e shpenzimeve të turistëve të huaj jorezidentë në vendin tonë ndaj totalit të eksportit të mallrave dhe shërbimeve është mesatarisht 47 %, ndërsa pesha specifike e shpenzimeve të shtetasve shqiptarë rezidentë, jashtë vendit tonë ndaj totalit të importit të mallrave dhe shërbimeve është mesatarish 24 %.

Fig 3. Pesha e shpenzimeve në %



Aktivitetet e lidhura direkt me turizmin (NVE Rev.2, 2-shifrore 55; 56; 77; 79), gjeneruan rreth 45 miliardë lekë vlerë të shtuar gjatë vitit 2018, duke kontribuar me rreth 2,8 % në PBB. Duke marrë në konsideratë efektet indirekte të shpenzimeve të turistëve në aktivitete të tjera ekonomike, ky kontribut është edhe më i lartë.



Tab 5. Vlera e shtuar sipas industrive të turizmit

Industritë	NVE Rev.2	Vlera e Shtuar (m In Lekë)				
		2014	2015	2016	2017	2018
Industritë e turizmit	55;56;77;79	28.332	30.785	34.042	38.393	45.193
Akomodimi (gjithsej)	55	4.158	4.709	6.274	8.067	8.904
Shërbime ushqimi dhe pije (gjithsej)	56	20.275	21.489	23.250	25.672	30.651
Agjenci udhëtimi, operator turistik, qira e makinave dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit (gjithsej)	77;79	3.900	4.587	4.518	4.655	5.638


Numri i vizitorëve të huaj për të punësuar

Gjatë vitit 2017 në vendin tonë erdhën rreth 5,1 milion shtetas të huaj, dëshirat dhe nevojat e të cilëve u plotësuan nga rreth 58 mijë të punësuar vetëm në aktivitetet e lidhura direkt me turizmin (NVE Rev.2, 2-shifrore 55; 56; 77; 79), që do të thotë çdo i punësuar në këto aktivitete i shërbente dhe kujdesej për rreth 88 vizitor të huaj.



5. KAPACITETET AKOMODUESE NË SHQIPËRI

Në vitin 2018, në gjithë vendin funksionuan 1.326 struktura akomoduese (hotele, motele, kampe, bujtina, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afatshkurtra), dhe janë vënë në dispozicion rreth 17 mijë dhoma dhe rreth 38 mijë shtretër.



rreth 13 shtretër për 1000 banorë

69 % e shtretërve janë shfrytëzuar (netë qëndrime) nga jo rezident

mesatarisht 2 shtretër për dhomë

kapacitetet maksimale janë vënë në dispozicion gjatë muajit Gusht (rreth 22 mijë dhoma dhe 53 mijë shtretër)

tremujori i tretë ka patur normën e shfrytëzimit më të lartë të shtretërve, rreth 46 %.



Çfarë ofruam gjatë 2018?

Tab 6. Tregues të lejeve të ndërtimit për njësi akomodues

Përshkrimi	Hotele dhe të ngjashme				
	2014	2015	2016	2017	2018
Numri i lejeve për ndërtim hotelesh	5	3	11	53	75
Sipërfaqe m ²	26	6	15	89	122
Vlera e përafërt (milion lekë)	811	162	1.246	2.909	3.771

Burimi: INSTAT

6. AKTIVITETE TË TJERA TURISTIKE

Në periudhën 2014-2018, numri vizitorëve që kanë vizituar parqet arkeologjike, muzetë, dhe kala e monumente të tjerë ka qenë afërsisht 3 milionë persona me një rritje 49,4 % për vitin 2018.

Gjatë vitit 2018, numri i vizitoreve që kanë vizituar kala dhe monumete të tjerë ka pasur rritjen mesatare vjetore më të lartë me 53,4 %, i ndjekur nga numri i vizitorëve në muze me 51,2 %, krahasuar me vitin 2017.

